



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

**K R Y E T A R
Brunilda Mersini**

**ME URDHËR DHE DELEGIMI
NËNKRYETAR
Joljana Llanaj**

PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – e hapur e thjeshtuar Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Rehabilitim I stacioneve te Autobuzeve Urban “

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT **Kodi CPV:**

45213311-6 - Punime ndërtimi për stacione autobuzesh

Fondi Limit: 6,686,227.10 (Gjashtë million e gjashtëqind e teëtdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzetë e shtatë pikë dhjetë) Leke pa TVSH

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 6(gjashte) jave

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumenteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar me lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve **2023, 2024 dhe 2025** të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

- Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Argumentimi Teknik :

Do të shërbej për bilancet për të parë se ka kyer apo jo kontrate të ngjashme lidhur me punët publike të cilat ka bërë. Dhe për të vërtetuar seriozitetin e operatoreve ekonomike .

2.3.2 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive:

- **NS-8 A** (Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri)

Operatorët ekonomikë duhet të kenë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë ata duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria	Pershkrimi i kategorisë	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NS-8	Ndertime parafabrikat me beton te armuar ,struktura metalike dhe druri	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Punime prishje ➤ Punime strukture dhe xhami ➤ Veshje fasade ➤ Bojatisje structure ➤ Punime dekoracioni ➤ Vendosje pllakash trotuar ➤ Instalime te fuqise dhe ndricimit ➤ Punime gjelberimi 	A

Kategoria e mesiperme eshte kerkuar referuar zerave te preventivit dhe vleres perkatese se ciles I pergjigjet klasifikimi i mesiperme.

Argumentim Teknik per se duhet inxhinieri elektrik :

NS-8 - A do te sherbej per struktura metalike dhe druri, përfshin montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinieri për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë

pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **muajin** e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht::

- Inxhinier elektrik 1 (nje)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit . Për inxhinierët duhet të paraqiten:Diploma, Kontratë individuale pune (*e vlefshme*),librezë pune, CV.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Argumentim Teknik per se duhet inxhinieri elektrik :

- **Inxhinieri elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve per rehabilitimin e stacioneve te autobuzave urban sipas volumeve ne preventiv:
 - **Prishje te rrjetit ekzistues**
 - **Instalime ndricimi**
 - **F.v ndricues Led**
 - **F.V priza shuko 2P 16A 220V hermetike**

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Sa më sipër, duke marre parasysh natyren e puneve te objektit te prokurimit, ka perzgjedhur stafin e inxhinierit elektrik , te cilet jane te nevojshem per realizimin e punimeve duke u bazuar ne natyren e kesaj pune.

- 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:
- a) Kontratë pune e vlefshme;
 - b) Diplomë

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, përcaktimi i Drejtuesit Teknik gjatë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndaloheq ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga rendësia e objektit të kontratës, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Argumentim Teknik per se duhet inxhinieri elektrik :

Drejtuesi teknik është përgjegjës përpara investitorit për rehabilitimin e stacioneve të Autobusave Urban , sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- **1 (një)** punonjës të disponojë certifikatë si "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune", e dhene nga nje organizem i akredituar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes/ **edhe me kontrate bashkepunimi**
- *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE.*

Argumentimi Ligjor :

Sipas Ligjit nr. 10237, date 18.2.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune", çdo subjekt punedhenes eshte i detyruar te emeruje nje punonjes te kualifikuar per mbikqyrjen dhe zbatimin e masave te sigurise ne vendin e punes.

Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë, sidomos ne kete kontrate ku dhe numuri I punojesve te kerkuar per realizimin e saj eshte i larte. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM-ne Nr.312/2010 është përcaktuar se: "Punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes."

Argumentim Teknik per se duhet siguria dhe shendeti ne pune:

-Parandalimi i aksidenteve – puna me mjete elektrike, saldim, mund të shkaktojë lëndime serioze.

-Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse – helmetë, doreza, syze, maska, çizme sigurie për të mbrojtur trupin nga prerjet, djegiet dhe lëndimet e tjera.

2.3.6.Operatori ekonomik pjesemarres per realizimin e punimeve objekt kontrate duhet disponoje fuqi punetore jo me pak se **10 punonjes** per muajin e fundit e vertetuar kjo me :

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

Kjo kërkesë do të quhet e përbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi Ligjor : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentim Teknik per se duhet 10 punonjës

Numri i përcaktuar i punonjësve është perlllogaritur si me poshte :

Numri i punonjësve 8 punonjës

Afati 6 jave

- 1- Saldator nevojitet per kryerjen e punimeve te struktures .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $927.68/8/30=3.9$ punetor*
- 2- Elektracist nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $30/8/30=0.13$ punetor*
- 3- Bojaxhi nevojitet per kryerjen e punimeve bojatisje .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $102.9/8/30=0.27$ punetor*
- 4- Pllakashtrues nevojitet per kryerjen e punimeve zerave te preventivit .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $13.125/8/30=0.44$ punetor*
- 5- Punetor dizanji nevojitet per kryerjen e punimeve dekoracioni .Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $30.6/8/30=0.13$ punetor*

Punetor te ndryshem nevojiten per kryerjen e punimeve te ndryshme sipas zerave te preventivit Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $687.45/8/30=2.86$ punetore

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $1883.63/8/30=7.8$ punetore

Punetor shtese -2 punonjës

Totali 10 punonjës

Listpagesat dhe vertetimet shikohen qarte lidhur me proceduren pasi jane te gjithë punonjësit ,inxhinieri ,drejtuesit teknik te cilet do te kryejne sherbimin dhe punen e

kerkuar nga ana jone si dhe realizimin e saj sipas kushteve te percaktuara ne dokumentat standarte.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Autovinc	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Tranxhe elektrike	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Saldatrice elektrike	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Zmeriltrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Trapano elektrike	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Kaska/kokore	në pronësi ose me qira	Copë 10
9	Jeleke kantjeri	në pronësi ose me qira	Copë 10
10	Komplet i ndihmes shpejte	në pronësi ose me qira	Copë 1

- a) *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) *Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash.*
- c) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas Deklaratës se shoqërisë ofertuese.*
- f) *Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.*

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te saktësisese informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do te konsiderohet kusht për skualifikim..

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin

Argumentimi Ligjor : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, bazuar në zërat e preventivit të punimeve.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet oraganizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

Argumentim Teknik per se duhen mjetet

Emri i mjetit	Sasi	Njesi	Argumentimi
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 3.5 ton	1	copë	Transport materiale te dala nga gërmimi apo prishjet dhe transport asfalti
Autovinc	1	copë	Transportim materialesh

Tranxhe elektrike	1	copë	Perdoret per prerjen e materiale te ndryshme metalike dhe druri
Saldatrice elektrike	1	copë	Perdoret per saldimin e strukturave metalike
Zmerilitrice	1	copë	Eshte pajisje qe perdoret per gerryerjen,lemimin dhe prerjen e materialeve
Trapano elektrike	1	copë	Eshte pajisje qe perdoret per shpime ne beton dhe struktura
Matrapik	1	copë	Eshte pajisje qe perdoret per prerje betoni dhe asfalti.
Jelekë	10	copë	Per sinjalistike dalluese per stafin
Kokore	10	copë	Per siguri e mbrojtje stafi
Kuti ndihme e shpejtë	1	copë	Per siguri e mbrojtje stafi

Argumentim Teknik per se duhen mjetet

- 1- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 3.5 ton duhet per prishjen e rrjetit ekzistues nga te cilat do te dalin te dala nga gërmimi apo prishjet dhe transport asfalti.
- 2- Autovinc do te sherbej per transport dhe mgritje e peshave.
- 3- Tranxhe elektrike do te sherbejne per prerjen e materiale te ndryshme metalike te thjeshta e cila ne ze te preventivit me volum 1.48 ton .
- 6- Saldatrice elektrike e cila do te sherbej per pergatitjen e konstruksioneve metalike, mbulimin e paneleve sanduic, veshjen e fasadesh me alukobonde, ,strukturen metalike per platforme aksesibiliteti, te cilat kane sasi te oreve te punes sipas manualit eshte: $927.68/8/30=3.9$ punetor
- 4- Zmerilitrice eshte pajisje e cila do te sherbej qe perdoret per gerryerjen,lemimin dhe prerjen e materialeve.
- 5- Trapano elektrike e cila sherben per te bere cpinin ne beton dhe struktura.
- 6- Matrapik e cila sherben per shyerje dhe prerje betoni.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, bazuar në zërat e preventivit të punimeve.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara për produktet në fjalë janë të rëndësishme për realizimin e vepres, për të përcaktuar përputhshmerinë e kërkesave të projekt preventivit dhe specifikimeve të produkteve.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT

- 1- Jetmira Hanaj Ekonomiste
- 2- Laura Aliaj Juriste
- 3- Orges Deraj Arkitekt (Specialist i fushës)